




Lidhja e Bizneseve të Kosovës
Business League of Kosovo
Povezivanje preduzeca na Kosovu

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E PODUJEVËS / OPSTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno 05.09.2024		
Nr. Org. Jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
02-016/01-0060797/24	4 fletë	
PODUJEVË - PODUJEVO		



Komuna e Podujevës
Municipality of Podujeva
Opština Podujevo

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI DHE BASHKËPUNIMI

Në mes
Palëve

LIDHJA E BIZNESEVE TË KOSOVËS, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson
Besart Dreshaj, Kryetar i Lidhjes.

Dhe

KOMUNA E PODUJEVËS, të cilën e përfaqëson Shpejtim Bulliqi, Kryetar i
Komunës.

Podujevë
2024

Lidhja e Bizneseve të Kosovës dhe Komuna e Podujevës, me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit afatgjatë, nënshkruajnë këtë:

Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi

Neni 1

1. Palët, Lidhja e Bizneseve dhe Komuna e Podujevës do të zhvillojnë forma të bashkëpunimit nga fushëveprimtaria e tyre.
2. Për këtë do të ndërtojnë lidhje të qëndrueshme në shkëmbimin e ekspertizës, përvojës dhe resurseve të përbashkëta në të mirë të zhvillimit ekonomik dhe turizmit të Komunës së Podujevës.
3. Palët do të mbështesin projektet reciproke, do të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta, si dhe do të realizojnë projekte të përbashkëta nga fushat e parapara në këtë Memorandum.
4. Palët gjithashtu do të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta me qëllim të vendosjes dhe zhvillimit të bashkëpunimit në të mirë të zhvillimit ekonomik të Komunës së Podujevës.

Neni 2

Memorandumi parasheh harmonizim të projekteve në mes Lidhjes së Bizneseve të Kosovës dhe Komunës së Podujevës me qëllim të afrimit me njëra tjetrën dhe që të inkurajohet bashkëpunimi ekonomik në të mirë të Komunës dhe sektorit privat.

Neni 3

1. Me këtë Memorandum synohet vendosja e marrëdhënieve ndërmjet palëve në procesin e implementimit të qëllimeve të përbashkëta. Pra në bazë të partneritetit do të zhvillohet bashkëpunimi në realizimin e promovimit të prodhimeve vendore "Java e Biznesit Kosovar", zhvillimit të projekteve ekonomike lokale, promovimit të bizneseve, investimeve të huaja, propozimeve lidhur me zhvillimin ekonomik lokal si dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta në Komunën e Podujevës.
2. Do të ofrohet bashkëpunim i mirëfilltë sa i përket zhvillimit të aktiviteteve ekonomike në Komunën e Podujevës për promovimin e prodhimeve vendore dhe turizmin si dhe projekteve tjera me karakter ekonomik në Komunën e Podujevës.
3. Do të organizohen takime të përbashkëta zyrtare, sipas nevojave të palëve në interes të Komunës sa i përket zhvillimit ekonomik lokal dhe sektorit privat.
4. Do të mbështeten nga Komuna e Podujevës projektet e përbashkëta të cilat janë në të mirë të Komunës dhe sektorit privat sa i përket zhvillimit ekonomik.

Neni 4

Nënshkrimi i këtij Memorandumi nga ana palëve bëhet duke pasë parasysh vullnetin e tyre në funksion të krijimit të marrëdhënieve për zhvillimin ekonomik të vendit, bizneseve, dhe ngritjes së shkëmbimeve bashkëpunuese të përvojave mes vete si dy Institucione.

Neni 5

Duke marrë për bazë rëndësinë ekonomike në forcimin e këtyre marrëdhënieve, dëshirën dhe vullnetin për të ofruar një model bashkëpunimi në fushat përkatëse në interes të zhvillimit ekonomik dhe bizneseve të Komunës së Podujevës.

Neni 6

1. Nga ky Memorandum do të jenë përfshirë sektori privat, prodhuesit vendor, turizmi malor i Komunës së Podujevës si dhe do të sjellën investitorë potencial të huaj në Komunën e Podujevës.
2. Memorandumi synon krijimin e një platforme për bashkëpunim të vazhdueshëm dhe konkret në mes Komunës dhe Komunitetit të biznesit, me fokus të veçantë në promovimin e prodhimeve vendore, turizmit, lehtësimin e procedurave administrative për bizneset, dhe përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm biznesor në Podujevë.
3. Objektivat kryesore të bashkëpunimit përfshijnë:
 - Promovimin e prodhimeve dhe shërbimeve vendore;
 - Lehtësimin e procedurave administrative për bizneset dhe përmirësimin e klimës së investimeve;
 - Avokimin e përbashkët për nisma ligjore që adresojnë sfidat e komunitetit të biznesit;
 - Promovimin e transparencës në proceset vendimmarrëse komunale;
 - Koordinimin mes vete sa i përket zhvillimit të politikave që stimulojnë rritjen ekonomike dhe tërheqjen e investimeve;
 - Angazhimin e bizneseve në adresimin dhe shqyrtimin e sfidave administrative dhe ligjore.
4. Ky Memorandum shënon fillim të ri në angazhimet e përbashkëta në funksion të përmirësimit të mjedisit ekonomik dhe përkrahjen e bizneseve në Komunën e Podujevës.
5. Komuna e Podujevës do të përkrahë projektet që kanë të bëjnë me mbështetjen e bizneseve në Komunën e Podujevës, me theks mbështetjen e prodhimeve vendore, mbështetjen në iniciativat e investimeve të huaja, dhe projekte tjera që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Komunës së Podujevës.
6. Komuna e Podujevës gjithashtu do të mbështet Lidhjen e Bizneseve të Kosovës, sipas ligjeve dhe rregullativës ligjore në fuqi, për aktivitetet të cilat do të organizohen në Komunën e Podujevës e që kanë të bëjnë me promovimin e prodhimeve, promovimin e sektorit malor dhe turizmin, mbështetjen e sektorit privat dhe zhvillimin ekonomik të Komunës.

Neni 7

1. Ky Memorandum do të fillon të implementohet me rastin e nënshkrimit nga të dyja palët.
2. Palët pajtohen që Memorandumi mund të ndryshohet dhe plotësohet apo mund të shkëputet, përmes një paralajmërimi me shkrim në mes palëve, duke përfshirë dhe duke shqyrtuar paraprakisht të gjitha arsyet dhe komponentët e ndryshim-plotësimit apo shkëputjes.

Neni 8

Palët zotohen që do të kontribuojnë në fushën ekonomike të vendit, në të mirë të zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

Neni 9

Memorandumi është i përpiluar në dy (2) ekzemplarë original, prej të cilave, pas nënshkrimit dhe protokolimit, nga një (1) ekzemplar i dorëzohet për secilën palë.

Neni 10

Memorandumi është nënshkruar më 05 shtator 2024, në pajtim me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës si dhe Statuteve të dy Institucioneve nënshkruese.

Në emër të:


Lidhjes së Bizneseve të Kosovës



Besart Dreshaj - Kryetar

Në emër të:

Komunës së Podujevës



Shpejtim Bulliq - Kryetar



